

Special
Ministry of Foreign Affairs
Tirane, 12/1/88

Perkthim jozyrtar

Note verbale

D. II
14/1
3

VN Nr. 9/88

Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë ka nderin të njoftojë Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë se më 1 janar 1988 Republika Federale e Gjermanisë ka marrë përsipër sipas turnit kryesive e bashkëpunimit politik evropian. Kryesia mbaron më 30 qershor 1988.

Ambasada perfiton nga ky rast për t'i perseritur Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë sigurimet të konsiderates së saj të lartë.

Tirane, më 12 janar 1988

Ministrinë e Punëve të Jashtme
të Republikës Popullore Socialiste të
Shqipërisë

Tirane



2

Botschaft
Bundesrepublik Deutschland
VN Nr. 9/88

V e r b a l n o t e

Die Botschaft der Bundesrepublik Deutschland beehrt sich dem Außenministerium der Sozialistischen Volksrepublik Albanien mitzuteilen, daß die Bundesrepublik Deutschland turnusgemäß am 01. Januar 1988 die Präsidentschaft der Europäischen Politischen Zusammenarbeit übernommen hat. Die Präsidentschaft endet am 30. Juni 1988.

Die Botschaft benutzt auch diesen Anlaß, das Außenministerium der Sozialistischen Volksrepublik Albanien seiner ausgezeichneten Hochachtung zu versichern. *M.*

Tirana, den 12. Januar 1988

An das
Außenministerium der
Sozialistischen Volksrepublik Albanien
Tirana



Sh. Sokrat,

mendojme qe kete note ta lreme ne heshtje,
por ne ndonje takim te rastit me ambasadorin
e RF te Gjermanise t'i vihet ne dukje se ne
rradhe te pare jemi te interesuar per qendri-
min e RFGj per probleme te ndryshme nderkombeta
re dhe jo per qendrimin e grupimeve, me te ci-
lat ne nuk jemi saktas. ; ngjohim .

20.4.1998

[Handwritten signature]
[Handwritten initials]

D. I. ...
[Handwritten signature]
[Handwritten number 3]



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME

Tirane, me 8.5.1989

DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 2082

AMBASADES SE RPS TE SHQIPERISE

ATHINE

(Shokut Izedin Hajdini)

T I R A N E

Ne bisede qe do te keni me ndonje person kompetent per Tregun e Perbashket Evropian, perpiquni te mesoni nese eshte e nevojshme qe perfundimi i nje marreveshje tregtare midis TPE dhe nje vendi te trete, qe siguron ose jo trajtim preferencial te ketij te fundit, duhet te paraprihet nga nje deklarate e vendit te trete, per njohjen politike te TPE. Per kete:

- Pergjigja duhet te jete e sakte.
- Mundesisht e dokumentuar me ndonje marreveshje qe TPE ka nenshkruar me ndonje vend te trete.
- Siguroni dhe dergoni kopje te marreveshjeve tregtare te pergjithshme, per mallra te veçante , si konfeksione, produkte bujqesore e blegtorale, etj. qe vende te treta kane nenshkruar me TPE.

Biseden e zhvilloni me takt e ne menyre indirekte. Ju kujtojme se problemi ka rendesi dhe qellimi eshte per studimin e ketij tregu.

Sa siper, na njoftoni dhe dergoni dokumentat perkate-

- 2 -

se me poste diplomatike brenda dates 25 maj 1989.

ZEVENDESMINISTRI

(Sokrat Plaka)



I n f o r m a c i o n

Sot, date 25 korrik 1989, shoku Andon Berxholi priti ambasadorin e RFGJ, F. Kronek, me kerkesen e ketij te fundit.

Ambasadori Kronek tha: kam ardhur qe tu nj oftoj emrat e funksionareve te TPE me te cilet mundet te takohen perfaqesuesite vendit tuaj per bisede informative, ashtu sikurse mi kerkuat.

Ata qe mundet te takoheni jane (i dorezoi edhe me shkrim):

1. John Maslen, pergjegjes referati ne Komisionin e Bashkesise Evropiane.
2. Perfaqesia e RFGJ ne Bashkesine Evropiane
 - a) per ceshtje politike ministri keshilltar Dohmes
 - b) per ceshtje ekonomike keshilltare ministeriale zonja Selz.

Jemi te intereuar te dime se cfare hapa do te ndermare pala shqiptare ne drejtim te TPE ? Ministria e jone eshte e gatshme te parkrahe dhe ndihmoje ne cdo hap qe do te ndermarre pala tuaj. Perfaqesuesi yne ne TPE eshte udhezuar te ndihmoje ne hapat tuaja. Shoku Ando falenderoi per pergjigjen dhe predispozicionin e pales gjermane per te ndihmuar.

Ne perfundim Kronek tha se Shqiperia duhet te bisedoje me Komisionin e Bashkesise Evropiane e kjo bisede nuk do te thotesse e njeh ate zyrtarisht. Eshte godeske qe p.sh vendet socialiste kane vendosur marredhenie me TPE e Shqiperia jo. Ne e shikojme te rendesishme qe Shqiperia te dergoje nje perfaqesues ne TPE, ne Bruksel se kjo do te nxite marredheniet ekonomike sepse te gjitha vendet anetare te TPE kopetencat ^{ekonomike} ja kane kaluar Brukselit. Thesoi se per vendimin qe do te marre pala shqiptare ne drejtim te TPE ^{pala gjermane do te merrte po} te ^{ekonomike} menjofte qe me perpara.

Shoku Andon i kerkoi qe pala gjermane te japi pergjigje per specialistet tane qe do shkojne ne RFGJ ne kuadrin e Bashkepunimit Ekonomik per kualifikim, ^{sepse ata jane ne perqendrime te} ^{prerive teknike e dete re huro do nisen.}
25.7.89

Dh.K.

*shimim: te njoftuar Pergjil te na njoftoj
re i fero nendshketeric ha John Maslen
25.7.89*

Nr. 2

Sh. Ramiz ✓
Sh. Astir ✓
Sh. Sajo ✓

166

Tirane, me 12.1.1990
12.1.90

MBI QENDRIMIN NDAJ TPE

Aktualisht midis 12 shteteve pjesemarrrese ne TPE po thellohet gjithmone e me teper procesi i integritimit. Zhvillimet e shpejta qe po ndodhin ne Evropen Lindore, veçanerisht politika e Gorbaçovit per "shtepine e perbashket evropiane", kane bere qe edhe ajo te filloje te perfshihet ne procesin e integritimit. TPE pretendon te luaj rolin udheheqes dhe kete e mbeshtet ne fuqine e madhe ekonomike si edhe ne krizen qe perjeton Evropa Lindore.

Tanime po duket qarte se TPE ka perfshire ne sferen e vete te integritimit, direkt ose indirekt, te gjithë Evropën Perendimore. Me grupin tjetër të vendeve të Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lire (EFTA), praktikisht është arritur lidhja doganore për qarkullimin e mallrave.

Grupimi i trete ekonomik ne Evrope, KNER-i, ne kushtet e sotme eshte larg realizimit te objektivit te tij per te krijuar tregun e vet unik midis shteteve anetare si kunderpeshe ndaj TPE, bile jane shfaqur shenja dizintegrimi dhe disa anetare te tij si psh. RDGJ e Hungaria kane shprehur deshiren per te hyre ne TPE.

Ne planin politik, tendenca eshte qe TPE te organizohet gjithmone e me teper si fuqi politike, duke u kthyer ne nje superfuqi evropiane, e duke u distancuar bile edhe nga SHBA.

- 2 -

Sot ai eshte afirmuar plotesisht ne marredheniet nderkombetare sepse mban marredhenie diplomatike me 120 vende, ka statusin e vezhguesit ne OKB e ne organizata te tjera boterore, merr pjese ne konferenca e traktate nderkombetare dhe nuk shtrohet me ceshtja e njohjes se tij.

Me krijimin e Tregut Unik me 1992, gjithnje e me shume shtetet anetare i kalojne TPE-se te drejtat e tyre sovrane, sidomos ne fushen ekonomiko-tregtare. Ne kete menyre, Komuniteti Evropian vepron si nje entitet me kompetenca ekskluzive ne rri-tje ne fushat doganore, te kontigjentimeve per mallrat e import-eksportit, per nenshkrimin ne emer te shteteve anetare te marre-veshjeve e protokolleve per bashkepunimin ekonomik, industrial, financiar, etj., me boten e jashtme. Ne keto kushte Komuniteti Evropian nuk mund te injorohet, sidomos ne marredheniet ekono-miko-tregtare te vendit tone me boten e jashtme.

Ne kushtet kur ne vitin 1992 do te formohet Tregu Unik, per te siguruar vazhdimesine e marredhenieve ekonomike, tregtare e financiare me secilin shtet anetar te komunitetit, qe sot behen ne rruge bilaterale, shtetit tone i duhet te hyje ne kontakte e marredhenie me TPE-ne. Ne marreveshjen baze flitet per proceduren per anetaresi ne TPE, ndersa nuk ka gje te per-caktuar per proceduren qe duhet te ndiqet nga shtetet joanetare efektive por qe duan te kene marredhenie me TPE.

Nga te dhenat qe kemi apo sipas praktikës nderkombetare per te hyre ne lidhje mund te veprohet sipas varianteve qe vijojne:

a) T'i dergohet nje leter kryetarit te Komisionit te TPE-se

- 3 -


sipas tekstit bashkelidhur. Letra te dorezohet permes Italise, e cila ka njoftuar se per kete vit perfaqeson dhe TPE ne Tirane.

b) T'i kerkohet zyrtarisht nje shteti anetar te TPE-se qe ne kemi marredhenie normale (ne rastin konkret Italise apo RF Gjermane, qe kane treguar interesim), te organizohet nje takim i perfaqesuesve tane me zyrtare te TPE ne Bruksel.

c) Te ftohet perfaqesuesi i TPE-se ne Athine per te bere nje vizite private ne Tirane dhe t'i jepen atij takime ne Ministrine e Puneve te Jashtme dhe ne Ministrine e Tregtise se Jashtme. Kjo te sherbeje si nje gjest i vendit tone ndaj TPE si dhe per te biseduar problemet aktuale te vendit tone me te.

Mendojme qe per tani te zbatohet varianti i dyte.

Reis Malile



RELACIONMBIVENDOSJEN E MARREDHENIEVE DIPLOMATIKE MIDIS RPS TE SHQIPERISE DHE BASHKESISE EKONOMIKE EVROPIANE (TPE)

Ne perputhje me vendimet e Plenumit te 10-te te KQ te PPSH eshte e nevojshme te behen veprimet perkatese zyrtare per vendosjen e marredhenieve diplomatike midis RPS te Shqiperise dhe Bashkesise Ekonomike Evropiane. Tanime eshte e qarte se TPE po shkon me shpejtesi drejt bashkimit te saj ekonomik, qe do te shpjere me pas ne bashkimin politik te shteteve anetare ne te. Ajo ka tanime marredhenie diplomatike me mbi 140 vende. Shqiperia mund te kete ambasadoren e saj prane Bashkesise Ekonomike Evropiane, direkt ne Bruksel ose te akredituar nga Tirana apo nje vend tjeter.

Pas vendosjes se marredhenieve hapet rruga per te zhvilluar bisedime e per te nenshkruar marreveshje te vecanta per tregtine, bashkepunimin ekonomik si dhe per kontribute financiare etj., qe praktikohen per vendet ne zhvillim dhe ato mesdhetare.

Nisur nga sa me siper do te fillojme menjehere kontakte per vendosjen e marredhenieve diplomatike midis RPS te Shqiperise dhe TPE-se.

MINISTRI
(Reis Malile)

Tirane, me 23 prill 1990






REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME

Tirane, me 5 maj 1990

Nr. 1682

AMBASADES SE RPS TE SHQIPERISE

(Shokut Ksenofon Nushi)

P A R I S

Bashkelidhur ju dergojme letren e ministrit te Puneve te Jashtme drejtuar kryetarit te Komisionit te Bashkesise Evropiane, Zhak Delor, qe do ta dorezoni ne Bruksel (njihuni edhe ju me permbajtjen e letres).

Kerko menjehere takim me drejtorin politik ne MPJ, Blot, e vere ne dijeni mbi permbajtjen e letres dhe foli per deshiren e vendit tone per te zhvilluar marredheniet me Bashkesine Evropiane(TPE). Shprehi besimin se per kete do te kemi bashkepunimin e Frances(per dijenine tuaj do t'i kerkojme ne menyre te veçante bashkepunim edhe Italise, e cila perfaqeson TPE ne Tirane).

Blotit i thuaq se deshiron te shkosh sa me pare ne Bruksel per te dorezuar letren. Pyete ate me cilin te rekomandon ai te takohesh ne Bruksel per kete qellim dhe ne se mund te ndihmoje, po te jete nevoja, per organizimin e takimit.

- 2 -

Pas kesaj , shoku Arqile Semini te marre ne telefon Protokollin e TPE ne Bruksel ose Drejtorine e marredhenieve me jashte dhe ta njoftoje se ambasadori Nushi deshiron te veje atje per te dorezuar nje leter te MPJ te Shqiperise per Zhak Delorin, te pyese se cilit personi pergjegjes mund t'ia dorezoje dhe kur; te shprehe deshiren se duam qe kete ta bejme ne nje kohe te shpejte. Po te pyesin kujt deshiron t'ia dorezoje letren ambasadori, ua lini ta vendosin ata, por mund t'u sugjeroni drejtorin e pergjithshem te marredhenieve me jashte (mbaj parasysh edhe sugjerimin qe mund te beje Bloti). Po te jete nevoja , u thoni se letra permban propozimin per vendosjen e marredhenieve diplomatike.

Ne Bruksel, ne vartesi te personit qe do te prese, bisedoni jo vetem per interesimin e Shqiperise per te zhvilluar bashkepunimin me TPE,por edhe per zgjerimin e marredhenieve nderkombetare te vendit tone ne pergjithesi, ne frymen e fjalimit te shokut Ramiz Alia ne Plenumin e 10-te te KQ te Partise.

Ne rast se eshte e mundur, paraprakisht, sqaro cilat jane modalitetet e nevojshme per vendosjen dhe shpalljen e marredhenieve diplomatike. Po keshtu interesohuni te mesosh mbi format e bashkepunimit, marreveshjet qe mund te perfundohen midis te dy paleve si dhe te siguron kopje te marreveshjeve. Me konkretisht keto mund te trajtohen pastaj nga perfaqesuesit e ministrise se Puneve te Jashtme, sikunder behet fjale ne leter.

Me te hyre ne lidhje me Protokollin e TPE na njoftoni menjehere kryerjen e veprimeve.

Pas dorezimit te letres, me t'u kthyer ne Paris kerko menjehere takim me ambasadorin e Irlandes aty dhe i dorezo me note percjellese nga ana e ambasades, "per dijeni" kopjen e letres drejtuar Zhak Delorit qe po e dergojme bashkelidhur. Ne biseden me ambasadorin e Irlandes i thuj atij se e quajme te nevojshme t'i veme ne dijeni per sa siper, duke patur pasqyren se Irlanda ka aktualisht kryesine e Keshillit te Ministrave te Bashkesive Evropiane.

M I N I S T R I

(Reis Malile)





REPUBLIQUE POPULAIRE SOCIALISTE D'ALBANIE
MINISTÈRE DES AFFAIRES ÉTRANGÈRES

Ministre

Tirana, le 4 mai 1990

Monsieur le Président,

J'ai l'honneur de porter à Votre connaissance que mon Gouvernement, partant du désir de voir la République populaire socialiste d'Albanie et les Communautés européennes entretenir des liens d'une coopération fructueuse et amicale, propose qu'entre elles soient établies les relations diplomatiques.

Dans ce cadre, j'apprécierais l'organisation, sous Vos auspices, d'une rencontre, à Bruxelles, entre des représentants du Ministère des Affaires Étrangères de la République populaire socialiste d'Albanie et des représentants des Communautés européennes, en vue


SON EXCELLENCE
MONSIEUR JACQUES DELORS
PRÉSIDENT DE LA COMMISSION
DES COMMUNAUTÉS EUROPÉENNES
B R U X E L L E S

- 2 -

d'examiner les procédures et les modalités requises.
A cette occasion, la partie albanaise souhaiterait
également être informée sur les formes de coopération.

Dans l'attente d'une réponse de Votre part, je
Vous prie d'agréer, Monsieur le Président, les assu-
rances de ma plus haute considération.

LE MINISTRE DES AFFAIRES ETRANGERES



Reis MALILE



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISE
MINISTRIA E PUNËVE TE JASHTME
DREJTORIA E BASHKEPUNIMIT SHUMEPALESH

Nr. 2137

Tirane, me 15.6.1990

AMBASADES SE RPS TE SHQIPERISE

R O M E

Bashkelidhur ju dergojme kopjen e letres qe shoku Reis Malile i ka drejtuar Kryetarit te Komisionit te Bashkesive Evropiane, Zhak Delor, me anen e se ciles propozohet vendosja e marredhenieve diplomatike midis Shqiperise dhe Bashkesive Evropiane. Letra eshte dorezuar ne Bruksel me daten 8 qershor 1990.

Me note dorezoheni ne Ministrine italiane te Puneve te Jashtme, duke theksuar se nisur nga marredheniet miqesore midis dy vendeve tona dhe nga fakti se Italia perfaqeson Bashkesine Evropiane ne Shqiperi dhe se shpejti ajo do te marre kryesine e saj, shprehim besimin se Italia do te beje perpjekje dhe do te jape kontributin e cmuar per vendosjen e marredhenieve diplomatike dhe te bashkepunimit midis Shqiperise dhe Bashkesive Evropiane.

Na njoftoni per veprimet qe do te kryeni.

ZEVENDESMINISTRI

(Muhamet Kapllani)



AMBASCIATA
DELLA REPUBBLICA POPOLARE SOCIALISTA D'ALBANIA
IN ITALIA

00199 Roma, 20 Giugno 1990
VIA ASMARA, 9
TEL. 83.80.726

64

Nr.

NOTA VERBALE

L'ambasciata della Repubblica Popolare Socialista d'Albania a Roma presenta i suoi complimenti al Ministero degli Affari Esteri della Repubblica Italiana ed ha l'onore di consegnarle in allegata copia del testo consegnato a Brussel, il 8 Giugno, che il Ministro degli Affari Esteri della Repubblica Popolare Socialista d'Albania, Rein Malile ha rivolto al Presidente della Commissione della Comunità Europea, Signor Jacque Delors, con la quale si propone di allacciare relazioni diplomatiche tra l'Albania e la Comunità Europea. Intanto, basandosi sulle relazioni già amichevoli tra due nostri paesi, nonchè sul fatto che l'Italia rappresenta la Comunità Europea in Albania, e che prenderà, tra pochi giorni, l'incarico della presidenza della Comunità Europea, si esprime l'ubbidienza che Ella farà tutti gli sforzi per far sì che si possano allacciarsi le relazioni diplomatiche e della collaborazione tra l'Albania e la Comunità Europea.

L'Ambasciata della Repubblica Popolare Socialista d'Albania si avvale dell'occasione di rinnovare al Ministero degli Affari Esteri della Repubblica Italiana i sensi della sua più alta considerazione.

MONSIEUR JACQUE DELORS
PRESIDENT DE LA COMMISSION
DES COMMUNAUTES EUROPEENNES
AL MINISTERO DEGLI AFFARI ESTERI
BRUXELLES
ROMA

